



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 29

Tiranë – E martë, 22 shkurt 2022

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 2/2022, datë 27.1.2022	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 36, datë 24.12.2021, “Për një shtesë në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, ‘Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar”..... 3525
Ligj nr. 9/2022, datë 27.1.2022	Për profesionin e ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme..... 3525
Ligj nr. 10/2022, datë 27.1.2022	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, i ndryshuar..... 3538
Dekret i Presidentit nr. 13478, datë 16.2.2022	Për shpallje ligji..... 3539
Ligj nr. 11/2022, datë 27.1.2022	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 3539
Dekret i Presidentit nr. 13479, datë 16.2.2022	Për shpallje ligji..... 3541
Dekret i Presidentit nr. 13480, datë 17.2.2022	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 3541
Urdhër i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 29, datë 1.2.2022	Për miratimin e përkthimit në gjuhën shqipe të ndryshimeve në Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar (SNRF) 17 “Kontratat e sigurimit”..... 3542
Urdhër i drejtorit të përgjithshëm të Arkivave nr. 126, datë 18.2.2022	Për delegim kompetencash..... 3545
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 2117, datë 17.2.2022	Mbi hyrjen në fuqi të marrëveshjeve ndërkombëtare..... 3545

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 18, datë 4.2.2022	Mbi depozitimin nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a.) për miratim në ERE të kontratës për ofrimin e shërbimeve të zyrtarit të pajtueshmërisë dhe kritereve për përzgjedhjen e tij.....	3545
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 19, datë 4.2.2022	Mbi shtyrjen e vendimmarrjes së Bordit, për kërkesën e shoqërisë “Hera” sh.p.k., për transferimin e plotë të licencës nr. 49, seria NPM07P, dhënë me vendimin e Bordit nr. 61, datë 2.11.2007, “Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale me erë (projekti KAPPET)”, i ndryshuar.....	3547
	Vendim (<i>i shkurtuar</i>) për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Artan Kajo.....	3548
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Lorenc Hatija.....	3548
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetases Evanthi Klemo.....	3548
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Klodian Londo.....	3548



LIGJ
Nr. 2/2022

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV,
ME FUQINË E LIGJIT, NR. 36,
DATË 24.12.2021, “PËR NJË SHITESË NË
LIGJIN NR. 9920, DATË 19.5.2008, ‘PËR
PROCEDURAT TATIMORE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË’,
TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 36, datë 24.12.2021, “Për një shtesë në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, ‘Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar”.

**KRYETARE
Lindita Nikolla**

Miratuar më datë 27.1.2022.

LIGJ
Nr. 9/2022

**PËR PROFESIONIN E NDËRMJETËSIT
TË PASURIVE TË PALUAJTSHME**

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Objekti**

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për ushtrimin e profesionit të ndërmjetësit të

pasurive të paluajtshme, të drejtat dhe detyrimet e tij, procedurën dhe masat disiplinore ndaj ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme.

**Neni 2
Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim rregullimin e ushtrimit të profesionit të ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme, mbrojtjen e interesave të ligjshme të ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme, si dhe të çdo shtetasi nëpërmjet garantimit të ligjshmërisë gjatë ndërmjetësimit të veprimeve juridike për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme ose të të drejtave reale mbi to.

**Neni 3
Përkufizime**

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Ministri” ose “ministra” është ministri ose ministria përgjegjëse për drejtësinë.

2. “Ndërmjetës i pasurive të paluajtshme” është personi fizik i certifikuar nga ministria përgjegjëse për drejtësinë për të ndërmjetësuar përfundimin e një marrëveshjeje për realizimin e veprimit juridik të kalimit të pronësisë së pasurive të paluajtshme ose të të drejtave reale mbi to.

3. “Pasuri e paluajtshme” ose “pasuri” është çdo send i paluajtshëm sipas kuptimit të Kodit Civil.

4. “Person i lidhur” është rrethi i personave që kanë marrëdhënie me ndërmjetësin e pasurive të paluajtshme ose kandidatin për ndërmjetës të pasurive të paluajtshme, i përbërë nga bashkëshorti, bashkëjetuesi, prindërit, fëmijët dhe çdo person tjetër i përmendur në certifikatën familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile, si dhe çdo person fizik ose juridik, që dihet botërisht se ka ose ka pasur marrëdhënie të ngushta biznesi.

5. “Regjistri i Ndërmjetësve të Pasurive të Paluajtshme” është regjistri i të dhënave për zyrat e ndërmjetësimit të pasurive të paluajtshme dhe ndërmjetësit e pasurive të paluajtshme administruar në përputhje me këtë ligj, në të cilin regjistrohen të dhënat për marrjen dhe heqjen e certifikatës së ushtrimit të profesionit të ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme, përmbushjen e detyrimeve ligjore, si dhe ecurinë disiplinore të tyre.



6. “Veprime juridike me pasuritë e paluajtshme” janë çdo lloj veprimi juridik, që ka si objekt kalimin e të drejtës së pronësisë së pasurive të paluajtshme ose të të drejtave reale mbi to, ku përfshihen, por pa u kufizuar, kontratë shitjeje, shkëmbimi, qiraje ose enfiteoze.

7. “Veprimtaria e ndërmjetësimit të pasurive të paluajtshme” është çdo veprimtari që kryen ndërmjetësi i pasurive të paluajtshme për të ndërmjetësuar përfundimin e një marrëveshjeje për realizimin e veprimit juridik të kalimit të pronësisë së pasurive të paluajtshme ose të të drejtave reale mbi to, duke përfshirë edhe publicitetin kur kryhet nga ndërmjetësi me qëllim promovimin e pasurisë së paluajtshme për palët e treta.

Neni 4 Parimet

Ndërmjetësi i pasurive të paluajtshme gjatë ushtrimit të profesionit udhëhiqet nga parimet bazë të profesionalizmit, të etikës, të barazisë së palëve, të integritetit dhe të konfidencialitetit.

KREU II VEPRIMTARIA E NDËRMJETËSIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME

Neni 5 Ushtrimi i profesionit të ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme

1. Profesionit i ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme mund të ushtrohet vetëm nga personi që është certifikuar për kryerjen e kësaj veprimtarie dhe është i regjistruar në Regjistrin e Ndërmjetësve të Pasurive të Paluajtshme në përputhje me kushtet e kriteret e parashikuara në këtë ligj.

2. Ndërmjetësi i pasurive të paluajtshme mund të ushtrojë veprimtarinë e tij edhe nëpërmjet mjeteve elektronike ose në distancë. Në çdo rast, kur veprimtaria ushtrohet nëpërmjet mjeteve elektronike ose në distancë, ndërmjetësi është i detyruar të njoftojë identitetin e tij, numrin e certifikatës, si dhe numrin unik të identifikimit të subjektit.

3. Çdo person tjetër që nuk është certifikuar për ushtrimin e profesionit të ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme nuk lejohet të ndërmjetësojë kryerjen e veprimeve juridike për kalimin e pasurive

të paluajtshme ose të të drejtave reale mbi to, pavarësisht formës ose mjetit që përdoret për ndërmjetësimin.

Neni 6 Kodi i Etikës Profesionale

1. Kodi i Etikës Profesionale përcakton standardet për respektimin dhe zbatimin e rregullave të etikës profesionale të ndërmjetësve të pasurive të paluajtshme, të drejtat dhe detyrat në marrëdhënie me klientët, ndërmjetësit e tjerë dhe institucionet shtetërore.

2. Kodi përcakton rregulla të hollësishme për të drejtat dhe përgjegjësitë profesionale të detyrueshme për zbatim në ushtrimin e veprimtarisë ndërmjetësuese.

3. Kodi miratohet me urdhër të ministrit pas marrjes së mendimit të ndërmjetësve të pasurive të paluajtshme ose shoqatave profesionale të tyre.

KREU III HYRJJA NË PROFESION

Neni 7 Organi certifikues

1. Ministri është autoriteti shtetëror përgjegjës, i cili u jep certifikatën individuale për ushtrimin e veprimtarisë së ndërmjetësimit të pasurive të paluajtshme personave fizikë që kërkojnë të ushtrojnë veprimtarinë e tyre si ndërmjetës të pasurive të paluajtshme në përputhje me rregullat dhe procedurat e parashikuara në këtë ligj.

2. Ministri jep certifikatën brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së dokumentacionit të nevojshëm, që vërteton përmbushjen e kriterëve të parashikuara në pikat 1, 2 dhe 3 të nenit 8 të këtij ligji. Ndërmjetësi i pasurive të paluajtshme pas marrjes së certifikatës dhe përpara fillimit të veprimtarisë regjistrohet në organet tatimore në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

3. Kërkesa për pajisjen me certifikatën individuale për ushtrimin e veprimtarisë së ndërmjetësimit të pasurive të paluajtshme konsiderohet e miratuar në heshtje nëse ministri nuk i njofton vendimin përkatës subjektit kërkuar brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, ose nuk njofton zgjatjen e afatit sipas përcaktimeve të nenit 97 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i



Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Neni 8

Kriteret për certifikimin si ndërmjetës i pasurive të paluajtshme

1. Personi që kërkon të certifikohet si ndërmjetës i pasurive të paluajtshme duhet të përmbushë kriteret e mëposhtme:

- a) të ketë zotësi të plotë juridike për të vepruar;
- b) të ketë përfunduar arsimin e mesëm të lartë, sipas legjislacionit në fuqi për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë;
- c) të mos jetë nën hetim apo gjykim për veprat penale në fushën e pastrimit të parave, të financimit të terrorizmit apo të armëve të shkatërrimit në masë;
- ç) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për një vepër penale të kryer me dashje për të cilën nuk është rehabilituar;
- d) të mos jetë dënuar me masë administrative gjobë ose masën administrative që detyron subjektin të ndalë një sjellje të caktuar, praktikë pune apo biznesi, si dhe të mos e përsërisë në të ardhmen, për shkelje të legjislacionit në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave, të paktën jo më herët se 6 muaj nga data e paraqitjes së kërkesës;
- dh) të ketë përfunduar programin e detyrueshëm të trajnimit për kandidatët për ndërmjetës të pasurive të paluajtshme.

2. Shtetasi i huaj, përveç kriterëve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të provojë që zotëron gjuhën shqipe me anë të paraqitjes së një dokumenti të lëshuar nga autoritetet kompetente sipas legjislacionit në fuqi.

3. Kandidatit për ndërmjetës të pasurive të paluajtshme mund t'i refuzohet e drejta e marrjes së certifikatës në rast se personat e lidhur me të janë të dënuar me vendim të formës së prerë për veprat penale në fushën e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit apo të armëve të shkatërrimit në masë.

4. Në rast se personat e lidhur me kandidatin për ndërmjetës janë të dënuar sipas përcaktimit të pikës 3 të këtij neni, ministri kërkon të dhëna, dokumente, fakte apo mjete të tjera të provës për përfshirjen e kandidatit për ndërmjetës në veprimtarinë e paligjshme të personit të lidhur nga Policia e Shtetit, prokuroria, gjykata, organet e administratës tatimore dhe doganore, Drejtoria e

Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Byroja Kombëtare e Hetimit, shërbimet shtetërore informative, si dhe nga çdo organ publik, person fizik ose juridik që disponon të dhëna të vlefshme për qëllimet e verifikimit. Nëse është e nevojshme, ministri kërkon të dhëna shtesë nga institucionet e përmendura në këtë pikë.

5. Ministri urdhëron refuzimin e së drejtës për të marrë certifikatën kur krijon bindjen që, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të raporteve të paraqitura nga institucionet kompetente, sipas pikës 4 të këtij neni, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit administrativ, kandidati për ndërmjetës është i përfshirë në veprimtarinë e paligjshme të personit të lidhur, pavarësisht nëse kandidati për ndërmjetës nuk është nën hetim për kryerjen e një vepre penale.

6. E drejta e marrjes së certifikatës për ushtrimin e profesionit të ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë pezullohet deri në marrjen e vendimit të formës së prerë të gjykatës nëse shtetasi në kohën e paraqitjes së kërkesës për t'u pajisur me certifikatën e ushtrimit të profesionit është nën hetim apo gjykim për një nga veprat penale të pastrimit të parave, të financimit të terrorizmit apo të armëve të shkatërrimit në masë.

7. Kandidatët paraqesin çdo dokumentacion të nevojshëm që vërteton përmbushjen e kriterëve të parashikuara në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk vërteton plotësisht përmbushjen e kriterëve, nuk është i plotë, i saktë, ose ka dyshime të arsyeshme për vërtetësinë e tij, ministria mund të kërkojë informacion ose dokumentacion shtesë nga çdo organ publik.

8. Rregullat e hollësishme për paraqitjen dhe trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimin të kriterëve ligjore përcaktohen me urdhër të ministrit.

Neni 9

Programi i detyrueshëm i trajnimit

1. Programi i detyrueshëm i trajnimit për kandidatët për ndërmjetës të pasurive të paluajtshme zhvillohet për një kohëzgjatje prej jo më pak se 60 orësh dhe ka si qëllim aftësimin e tyre me njohuritë e duhura profesionale për ushtrimin e veprimtarisë e veçanërisht për të raportuar transaksionet e dyshimta me pasuritë e



paluajtshme, të cilat mund të kenë si qëllim realizimin e pastrimit të parave ose financimin e terrorizmit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

2. Programi i detyrueshëm i trajnimit realizohet nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, nga institucione të arsimit të lartë të akredituara sipas ligjit ose nga shoqatat profesionale të ndërmjetësve të pasurive të paluajtshme pas miratimit nga ministri.

3. Pas përfundimit të programit të detyrueshëm të trajnimit, kandidati për ndërmjetës të pasurive të paluajtshme pajiset me certifikatën për përfundimin e tij.

4. Përmbajtja dhe organizimi i programit të detyrueshëm të trajnimit, pjesëmarrja në trajnim, kohëzgjatja, mënyra e zhvillimit dhe e kontrollit të njohurive, si dhe tarifat e trajnimit përcaktohen në rregulloren e programit të detyrueshëm të trajnimit, e cila miratohet me urdhër të ministrit.

Neni 10

Organizimi i ndërmjetësve të pasurive të paluajtshme

1. Ndërmjetësi i pasurive të paluajtshme ushtron veprimtarinë në mënyrë individuale, i organizuar në zyra të ndërmjetësimit të pasurive të paluajtshme ose si i punësuar pranë një zyre ndërmjetësimi të pasurive të paluajtshme.

2. Ndërmjetësit dhe zyrat e ndërmjetësimit të pasurive të paluajtshme kanë detyrimin e regjistrimit në regjistrin tregtar në një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

3. Në rastet kur veprimtaria e ndërmjetësimit të pasurive të paluajtshme ushtrohet nëpërmjet organizimit në zyra ndërmjetësimi, të regjistruara si person juridik në një nga format e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, ndërmjetësimi i veprimeve juridike me pasuritë e paluajtshme kryhet vetëm nga subjektet që janë të pajisura me certifikatën e ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme, sipas parashikimeve të këtij ligji.

4. Kur ortaku ose aksionari i zyrës së ndërmjetësimit të pasurive të paluajtshme nuk është i pajisur me certifikatën e ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme, zyra e ndërmjetësimit të pasurive të paluajtshme mund të regjistrohet në

regjistr sipas nenit 12 të këtij ligji vetëm kur ortaku ose aksionari plotëson kushtet e mëposhtme:

a) të mos jetë nën hetim apo gjykim për veprat penale në fushën e pastrimit të parave, të financimit të terrorizmit apo të armëve të shkatërrimit në masë;

b) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për një vepër penale të kryer me dashje për të cilën nuk është rehabilituar;

c) të mos jetë dënuar me masë administrative gjobë ose me masë administrative që detyron subjektin të ndalë një sjellje të caktuar, praktikë pune apo biznesi, si dhe të mos e përsërisë në të ardhmen, për shkelje të legjislacionit në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave, të paktën jo më herët se 6 muaj nga data e paraqitjes së kërkesës;

ç) personat e lidhur me të të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë për veprat penale në fushën e pastrimit të parave, të financimit të terrorizmit apo të armëve të shkatërrimit në masë.

5. Në rast se personat e lidhur me ortakun ose aksionarin e zyrës së ndërmjetësimit të pasurive të paluajtshme janë të dënuar sipas përcaktimit të shkronjës “ç” të pikës 4 të këtij neni, ministri kërkon të dhëna, dokumente, fakte apo mjete të tjera të provës për përfshirjen e ortakut ose të aksionarit në veprimtarinë e paligjshme të personit të lidhur nga Policia e Shtetit, prokuroria, gjykata, organet e administratës tatimore dhe doganore, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Byroja Kombëtare e Hetimit, shërbimet shtetërore informative, si dhe çdo organ publik, person fizik ose juridik, që disponon të dhëna të vlefshme për qëllimet e verifikimit. Nëse është e nevojshme, ministri kërkon të dhëna shtesë nga institucionet e përmendura në këtë pikë.

6. Ministri urdhëron refuzimin e regjistrimit në Regjistrin e të Dhënave për Zyrat e Ndërmjetësimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Ndërmjetësit e Pasurive të Paluajtshme kur:

a) nuk plotëson kriteret e parashikuara nga shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 4 të këtij neni;

b) krijon bindjen që, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të raporteve të paraqitura nga institucionet kompetente, sipas pikës 5 të këtij neni, si dhe në rezultatit tërësor të hetimit administrativ, ortaku ose aksionari është i përfshirë në veprimtarinë e paligjshme të personit të lidhur, pavarësisht nëse ortaku ose aksionari nuk është nën hetim për kryerjen e një vepre penale.



7. Ministri, kur urdhëron refuzimin e regjistrimit në regjistër sipas pikës 6 të këtij neni, vendos edhe ndalimin e ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme për ushtrimin e veprimtarisë së ndërmjetësit, i organizuar ose i punësuar në një zyrë ndërmjetësimi, e cila nuk është e regjistruar në regjistër, si dhe, kur është rasti, kryerjen e inspektimeve të rregullta në vend jo më pak se 2 herë në vit, sipas parashikimit të pikës 8 të nenit 21 të këtij ligji.

Neni 11

Ndërmjetësi i huaj i pasurive të paluajtshme

1. Profesionin e ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ka të drejtë ta ushtrojë edhe çdo shtetas shqiptar ose i huaj, që është pajisur me licencën e ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian sipas rregullave të atij shteti anëtar dhe ka nënshkruar një kontratë bashkëpunimi me një zyrë ndërmjetësimi të pasurive të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë.

2. Ndërmjetësi i huaj i pasurive të paluajtshme, i cili ushtron rregullisht profesionin në territorin e Republikës së Shqipërisë për jo më pak se 6 muaj pranë një zyre ndërmjetësimi të pasurive të paluajtshme, në përputhje me pikën 1 të këtij neni mund të kërkojë pranë ministrit të drejtën për të ushtruar në mënyrë të pavarur profesionin e ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë.

3. Ministri, pasi vërteton përmbushjen e kriterëve të parashikuara nga shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d” të pikës 1, si dhe pikat 2 e 3 të nenit 8 të këtij ligji, vendos regjistrimin e ndërmjetësit në Regjistrin e Ndërmjetësve të Pasurive të Paluajtshme.

4. Rregullat e hollësishme për njohjen e së drejtës së ushtrimit të profesionit në mënyrë të pavarur nga ndërmjetësi i huaj i pasurive të paluajtshme, si dhe të bashkëpunimit të tij me zyrat e ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme sipas këtij neni përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Neni 12

Regjistri i Ndërmjetësve të Pasurive të Paluajtshme

1. Ministria administron Regjistrin e të Dhënave për Zyrat e Ndërmjetësit të Pasurive të Paluajtshme dhe Ndërmjetësit e Pasurive të Paluajtshme.

2. Regjistri, sipas pikës 1 të këtij neni, ruhet, mirëmbahet e përditësohet në format të integruar manual dhe elektronik nga strukturat përgjegjëse të ministrisë.

3. Ndërmjetësit e pasurive të paluajtshme dhe zyrat e ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme regjistrohen në regjistër.

4. Ndërmjetësit e pasurive të paluajtshme dhe zyrat e ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme janë të detyruar të njoftojnë ministrinë për çdo ndryshim në të dhënat e detyrueshme për t'u regjistruar në regjistër jo më vonë se 30 ditë nga data e certifikimit, regjistrimit ose nga ndryshimi i të dhënave të detyrueshme për t'u regjistruar.

5. Ruajtja dhe përpunimi i të dhënave personale të regjistruara në regjistër bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

6. Strukturat përgjegjëse të ministrisë përditësojnë dhe kontrollojnë Regjistrin e Ndërmjetësve të Pasurive të Paluajtshme me listën e personave të shpallur, sipas legjislacionit në fuqi për masat kundër financimit të terrorizmit. Në ato raste kur konstatohet se një ndërmjetës i pasurive të paluajtshme ose personat e lidhur me të rezultojnë në listën e personave të shpallur, struktura përgjegjëse e ministrisë njofton autoritetin kompetent shtetëror për marrjen e masave në përputhje me legjislacionin në fuqi për masat kundër financimit të terrorizmit. Në këtë rast, ministri, sipas përcaktimeve të këtij ligji, me urdhër vendos heqjen e certifikatës së ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme dhe çregjistrimin nga Regjistri i Ndërmjetësve të Pasurive të Paluajtshme.

7. Rregullat e hollësishme për të dhënat që përmban Regjistri i Ndërmjetësve të Pasurive të Paluajtshme, formatin e tij, mënyrën e mbajtjes, të dhënat që mund të bëhen publike, si dhe rregullat për përditësimin e tyre përcaktohen me urdhër të ministrit.



KREU IV

KONTRATA PËR NDËRMJETËSIMIN E
PASURIVE TË PALUAJTSHME

Neni 13

**Kontrata për ndërmjetësimin e veprimeve
juridike me pasuritë e paluajtshme**

1. Ndërmjetësi lidh me klientin kontratën për ndërmjetësimin e veprimeve juridike me pasuritë e paluajtshme përmes së cilës ndërmjetësi merr përsipër, sipas kërkesave të klientit, të ndihmojë në realizimin e veprimit juridik të kërkuar, kundrejt pagesës së tarifës përkatëse.

2. Kontrata e ndërmjetësimit bëhet me shkresë, ndryshe nuk është e vlefshme dhe në të përcaktohen, ndër të tjera, edhe detyrimet e ndërsjella të palëve, kohëzgjatja e kontratës dhe kushtet e tjera thelbësore të saj.

3. Nëse palët nuk kanë përcaktuar kohëzgjatjen e kontratës së ndërmjetësimit të pasurive të paluajtshme, konsiderohet se kontrata e ndërmjetësimit është e lidhur për një afat prej 6 muajsh.

Neni 14

**Kushtet thelbësore të kontratës së
ndërmjetësimit**

1. Kontrata e ndërmjetësimit duhet të përmbajë kushtet sipas të cilave realizohet ndërmjetësimi, në veçanti:

- a) të dhënat identifikuese të palëve;
- b) objektin e kontratës së ndërmjetësimit;
- c) të drejtat e detyrimet e palëve;
- ç) tarifën e ndërmjetësimit, si dhe rregullat për kryerjen e saj;

d) veprimet përgatitore për përfundimin e veprimit juridik për të cilin është lidhur kontrata e ndërmjetësimit;

dh) llojin, ndarjen dhe vlerën e shpenzimeve që mund të ketë ndërmjetësi nëse, në marrëveshje me klientin, do të kryejë edhe veprime të tjera të lidhura me veprimin juridik.

2. Ndërmjetësi është i detyruar të publikojë në një vend të dukshëm e të lexueshëm për klientin kushtet e përgjithshme, si dhe tarifën që zbatohen prej tij.

Neni 15

Kontrata e ndërmjetësimit ekskluziv

1. Me kontratën e ndërmjetësimit ekskluziv klienti merr përsipër të mos angazhojë ndërmjetës tjetër për të njëjtin objekt të kontratës së ndërmjetësimit ekskluziv. Ky detyrim duhet të jetë i përcaktuar shprehimisht në kontratën e ndërmjetësimit.

2. Nëse gjatë kohëzgjatjes së kontratës për ndërmjetësim ekskluziv klienti ka kryer të njëjtin veprim juridik për të cilin ka lidhur kontratën me ndërmjetësin e parë, personalisht apo nëpërmjet një ndërmjetësi tjetër, duke shkelur detyrimet e kësaj kontrate, ai është i detyruar t'i paguajë ndërmjetësit ekskluziv tarifën e ndërmjetësimit sipas përcaktimeve në kontratën e ndërmjetësimit ekskluziv.

Neni 16

Përfundimi i kontratës së ndërmjetësimit

1. Një kontratë ndërmjetësimi e lidhur për një periudhë të caktuar kohe përfundon me mbarimin e afatit për të cilin është lidhur nëse veprimi juridik për kalimin e pronësisë së pasurive të paluajtshme ose të drejtat reale mbi to, për të cilin është ndërmjetësuar, nuk është kryer brenda asaj periudhe.

2. Nëse brenda 6 muajve pas përfundimit të kontratës së ndërmjetësimit klienti përfundon një veprim juridik që rrjedh nga veprimet e ndërmjetësit të kryera para përfundimit të kontratës së ndërmjetësimit, ai është i detyruar t'i paguajë ndërmjetësit tarifën e plotë, përveç kur në kontratë është parashikuar ndryshe.

KREU V

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E
NDËRMJETËSVE

Neni 17

Kujdesi në ushtrimin e veprimtarisë

Ndërmjetësi në kryerjen e veprimtarisë së ndërmjetësimit apo të veprimeve të tjera që lidhen me punën, që është objekt i ndërmjetësimit, është i detyruar të veprojë me kujdesin e duhur profesional, si dhe në përputhje me ligjin dhe me rregullat e ushtrimit të profesionit.



Neni 18

Të drejtat e ndërmjetësit

Ndërmjetësi i pasurive të paluajtshme gjatë ushtrimit të veprimtarisë ka të drejtë:

a) të ofrojë shërbimin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi në mënyrë të lirë dhe autonome, pa kufizime, kundrejt çdo klienti, vendas ose të huaj;

b) të informohet për të gjitha rrethanat që janë të rëndësishme për ndërmjetësimin dhe t'i vendosen në dispozicion prova për përmbushjen e detyrimeve ndaj palëve të treta;

c) të sigurojë dokumentacionin që vërteton pronësinë e klientit për pasuritë e paluajtshme, objekt kontrate, dhe të informohet nga klienti për të gjitha pengesat që ekzistojnë në pasuritë e paluajtshme;

ç) të kërkojë të dhëna që kanë lidhje me pasuritë e paluajtshme, objekt ndërmjetësimi, nga organi shtetëror që administron regjistrin e pasurive të paluajtshme, me qëllim përfitimin e informacionit të saktë dhe të plotë në lidhje me gjendjen juridike dhe kufizimet e vendosura mbi pasurinë e paluajtshme, pasi të ketë përmbushur detyrimet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi;

d) të përfitojë pagesën e tarifës së ndërmjetësimit, si dhe çdo shpërblim për shpenzime të tjera sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe kontratës së ndërmjetësimit;

dh) të rimbursohet për shpenzimet e bëra gjatë ndërmjetësimit, që tejkalojnë kostot e zakonshme të ndërmjetësimit, përveç rasteve kur është parashikuar ndryshe.

Neni 19

Detyrimet e ndërmjetësit

Ndërmjetësi i pasurive të paluajtshme gjatë ushtrimit të veprimtarisë kryen detyrat e mëposhtme:

a) kryen veprime që kanë si qëllim që të gjejnë dhe të lidhin klientin me palën tjetër të veprimit juridik eventuale, me qëllim kalimin e pronësisë ose të të drejtave reale mbi pasuritë e paluajtshme për të cilat është lidhur kontrata e ndërmjetësimit;

b) kryen shërbimin e ndërmjetësimit në çdo rast mbi bazën e një marrëveshjeje me shkrim të lidhur ndërmjet tij dhe klientit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

c) sigurohet që përpara lidhjes së kontratës së ndërmjetësimit, pala ka të drejtën për të disponuar lirisht mbi pronën ose të drejtat e tjera reale mbi pasuritë e paluajtshme objekt ndërmjetësimi, sipas dokumentacionit të paraqitur nga klienti;

ç) mban të dhëna për pasuritë e paluajtshme për të cilat ai ndërmjetëson. Këto të dhëna ruhen nga ndërmjetësi në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

d) informon klientin për të gjitha rrethanat që lidhen me veprimin juridik për të cilin po realizohet ndërmjetësimi, si dhe e këshillon për pasojat juridike që rrjedhin nga veprimet procedurale, me qëllim që të mos dëmtohen interesat e tij;

dh) ruan sekretin profesional dhe nuk zbulon të dhëna, të cilat i ka mësuar gjatë veprimtarisë së tij profesionale ose nga dokumentet që i janë vënë në dispozicion nga klienti, përveç kur dhënia e këtij informacioni është detyrim ligjor;

e) raporton çdo dyshim që ka për rastet kur e di apo dyshon se po kryhet, është kryer, apo tentohet të kryhet pastrimi i produkteve të veprës penale apo financimi i terrorizmit, si dhe për çdo rast tjetër për të cilin ka detyrimin për të raportuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

ë) vepron me profesionalizëm, besnikëri, ndershmëri dhe dinjitet, si dhe udhëhiqet nga interesat e klientit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) detyrohet të kthejë çdo dokumentacion origjinal të siguruar nga klienti me përfundimin e marrëveshjes ndërmjet tij dhe klientit;

g) përmbush në mënyrë të rregullt detyrimet tatimore dhe çdo detyrim tjetër;

gj) çdo detyrë tjetër sipas parashikimeve të këtij ligji dhe marrëveshjes me shkrim të lidhur me klientin.

Neni 20

Tarifa e ndërmjetësimit

1. Tarifa e ndërmjetësimit përcaktohet në kontratën e ndërmjetësimit të pasurive të paluajtshme.

2. Ndërmjetësi ka të drejtë të shpërblehet kur përmbushet objekti i kontratës, pavarësisht nga ngjarjet e mëvonshme që mund të ndodhin pas përmbushjes së objektit të kontratës.



3. Ndërmjetësi nuk mund të kërkojë pagesa të pjesshme të tarifës përpara lidhjes së kontratës. Nëse ndërmjetësi kryen shërbime shtesë që lidhen me punën objekt ndërmjetësimi, shpenzimet për kryerjen e tyre mund të përfshihen nga ndërmjetësi në shumën e shpenzimeve që realizohen nga ekzekutimi i kontratës, vetëm me pëlqimin e shprehur ndërmjet ndërmjetësit dhe klientit.

KREU VI PROCEDIMI DISIPLINOR I NDËRMJETËSIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME

Neni 21

Mbikëqyrja e ndërmjetësve të pasurive të paluajtshme

1. Ministri kryen mbikëqyrjen e veprimtarisë së përgjithshme të ndërmjetësve të pasurive të paluajtshme në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë ligj.

2. Mbikëqyrja e ndërmjetësve të pasurive të paluajtshme realizohet nga struktura përgjegjëse e ministrisë nëpërmjet kontrolleve periodike ose mbi bazën e ankesave të paraqitura.

3. Ministri kryen inspektime të rregullta në vend për të gjitha aktet, si dhe për çdo dokumentacion tjetër të veprimtarisë së ndërmjetësimit të pasurive të paluajtshme.

4. Ministri urdhëron inspektime të posaçme në rastet kur e sheh të nevojshme.

5. Ministri mbikëqyr veprimtarinë e ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme në lidhje me zbatimin e ligjit, Kodin e Etikës Profesionale, veçanërisht zbatimin e legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, duke u bazuar edhe në metodologjinë e identifikimit dhe vlerësimin e rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

6. Standardet dhe metodologjia e inspektimit të veprimtarisë së ndërmjetësve të pasurive të paluajtshme miratohen me urdhër të ministrit.

7. Në rast se ekziston një dyshim i arsyeshëm, informacion ose e dhënë që lidhet me shkeljen e legjislacionit në fuqi për luftën kundër pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit, ministri i raporton menjëherë autoritetit përgjegjës sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të

terrorizmit. Në këtë rast, ministri dhe Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave mund të urdhërojnë kryerjen e inspektimeve të përbashkëta.

8. Në rast se personat e lidhur me ndërmjetësin e pasurive të paluajtshme janë nën hetim, gjykim apo të dënuar për veprat penale në fushën e pastrimit të parave, të financimit të terrorizmit apo të armëve të shkatërrimit në masë, ministri urdhëron inspektime të rregullta në vend për të gjitha aktet, si dhe për çdo dokumentacion tjetër të veprimtarisë së ndërmjetësimit të pasurive të paluajtshme jo më pak se 2 herë në vit. Ndërmjetësi i pasurive të paluajtshme i nënshtrohet inspektimit sipas kësaj pike deri në 2 vjet nga data e vendimit gjyqësor të formës së prerë, që ka vendosur çështjen ndaj personit të lidhur, ose në rastin kur personi i lidhur është dënuar, gjatë ekzekutimit të dënimit deri në 2 vjet nga data e kontaktit të fundit me personin e lidhur.

Neni 22

Shkeljet dhe masat disiplinore

1. Ndërmjetësi i pasurive të paluajtshme kryen shkelje disiplinore në rastet kur:

a) vepron në kundërshtim me këtë ligj;

b) kryen veprime ose mosveprime që përbëjnë shërbime të papërshtatshme profesionale, të cilat janë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi ose Kodin e Etikës Profesionale.

2. Për shkelje të dispozitave që rregullojnë ushtrimin e profesionit dhe veprimtarinë e ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme jepen masat disiplinore si më poshtë:

a) paralajmërim me shkrim;

b) vërejtje me paralajmërim për heqjen e certifikatës për ushtrimin e profesionit të ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme;

c) gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë;

ç) urdhër ndërmjetësit për të kryer trajnim shtesë, përfshirë trajnim në etikë profesionale dhe/ose trajnim në fushën e parandalimit të pastrimit të parave;

d) pezullim nga detyra për një periudhë nga 1 deri në 5 vjet;

dh) heqje përfundimtare e certifikatës për ushtrimin e profesionit të ndërmjetësit të pasurive



të paluajtshme dhe çregjistrim nga Regjistri i Ndërmjetësve të Pasurive të Paluajtshme.

3. Masa disiplinore e dhënë ndaj ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme jepet në proporcion me shkeljen dhe bazohet në kriteret e mëposhtme:

- a) shkallën e pakujdesisë;
- b) shpeshtësinë e kryerjes së shkeljes;
- c) rrethanat e kryerjes së shkeljes, mundësinë e ardhjes së pasojave, si dhe dëmin e shkaktuar nga shkelja.

4. Gjoha mund të shoqërohet në mënyrë kumulative me masa të tjera disiplinore, të parashikuara nga shkronjat “a”, “b” dhe “ç” të pikës 2 të këtij neni.

5. Masat disiplinore të parashikuara në shkronjat “a” “b”, “c” dhe “ç” të pikës 3 të këtij neni jepen me urdhër të ministrit. Masat disiplinore të parashikuara në shkronjat “d” dhe “dh” të pikës 2 të këtij neni jepen me vendim të komisionit disiplinor.

6. Shkeljet disiplinore parashkruhen brenda 5 vjetëve nga koha kur ka ndodhur shkelja.

Neni 23

Fillimi i hetimit disiplinor

1. Ministri ka të drejtë të fillojë hetimin disiplinor kryesisht ose mbi bazë ankese për shkeljen e pretenduar bazuar në të dhëna prej të cilave lind dyshimi i arsyeshëm se shkelja mund të jetë kryer.

2. Ministri, me urdhër, vendos fillimin e hetimit kryesisht duke parashtruar rrethanat faktike, të cilat krijojnë dyshimin e arsyeshëm që shkelja mund të jetë kryer. Urdhri në çdo rast i njoftohet edhe ndërmjetësit.

3. Ministri vendos të fillojë hetimin për shkeljen e dyshuar ose të arkivojë një ankesë brenda 3 muajve nga marrja e ankesës.

4. Rregullat e hollësishme për procedurën e hetimit disiplinor, të filluar kryesisht apo mbi bazë ankese, si dhe formulari i ankesës miratohen me urdhër të ministrit.

Neni 24

Ankesat

1. Çdo person fizik ose juridik ka të drejtë t'i paraqesë ministrit ankesa të arsyetuara me shkrim.

2. Në rastet kur ka të dhëna të besueshme që ndërmjetësi i pasurive të paluajtshme mund të ketë kryer shkelje disiplinore, çdo funksionar publik që ka dijeni duhet të informojë ministrin.

3. Ministri ka detyrimin të shqyrtojë të gjitha ankesat, përveç atyre anonime. Ankuesi ka të drejtë të kërkojë ruajtjen e konfidencialitetit.

4. Tërheqja e ankesës nga ankuesi nuk sjell arkivimin e ankesës dhe mbylljen e hetimit të filluar nëse ministri vlerëson që ka shkaqe të mjaftueshme për kryerjen e hetimit me iniciativën e tij.

Neni 25

Të drejtat dhe detyrimet e ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme gjatë hetimit disiplinor

1. Ndërmjetësi i pasurive të paluajtshme është palë në proces që nga momenti i fillimit të hetimit dhe i garantohet aksesin në dosjen e hetimit në atë masë që është në përputhje me objektin e hetimit.

2. Ministri mund të kërkojë nga ndërmjetësi i pasurive të paluajtshme informacione, dokumente ose çdo provë që është e nevojshme për hetimin.

3. Ministri i njofton ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme ose përfaqësuesit të tij vendimin për arkivimin e ankesës, për fillimin e hetimit, shtimin ose ndryshimin e objektit të tij, si dhe mbylljen e hetimit.

Neni 26

Pezullimi i hetimit disiplinor

1. Ministri urdhëron pezullimin e hetimit disiplinor kur është duke u zhvilluar një hetim penal ose një proces gjyqësor penal, administrativ ose civil në të cilët:

a) njëra nga palët është ndërmjetësi i pasurive të paluajtshme; si dhe

b) shkelja e dyshuar lidhet me të njëjtat fakte për të cilat do të merret vendimi.

2. Hetimi disiplinor pezullohet deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjet e përmendura në pikën 1 të këtij neni.

3. Ministri u njofton urdhrin e pezullimit ankuesit, ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme, si dhe gjykatës ose prokurorisë. Gjykata ose prokuroria njoftojnë menjëherë ministrin për çdo vendim që merret, që heq shkakun e pezullimit të hetimit disiplinor sipas pikës 1 të këtij neni.



4. Vendimi gjyqësor i formës së prerë, në favor të ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme, nuk pengon hetimin nga ministri për të përcaktuar përgjegjësinë disiplinore të ndërmjetësit.

5. Pezullimi i hetimeve ndërpret afatet e parashkrimit, të parashikuara nga neni 22 i këtij ligji.

Neni 27

Përfundimi i hetimit disiplinor

1. Në përfundim të hetimit, nëse ka dyshime të arsyeshme që ndërmjetësi i pasurive të paluajtshme ka kryer shkelje disiplinore, ministri fillon procedimin disiplinor, duke paraqitur pranë komisionit disiplinor raportin e hetimit së bashku me dosjen hetimore.

2. Ministri mbyll hetimin nëse provohet që pretendimet janë të pabazuara ose provat e mbledhura dhe rezultatet e hetimit të çojnë drejt përfundimit se:

a) provat janë të pamjaftueshme për të provuar kryerjen e shkeljes disiplinore;

b) çështja ka qenë objekt i një hetimi të mëparshëm që është mbyllur ose për të cilën është dhënë vendim i formës së prerë, në kuadër të një procedimi disiplinor, përveç rasteve kur paraqiten fakte ose prova të reja;

c) çështja është parashkuar në kohën kur është filluar hetimi;

ç) ndërmjetësi i pasurive të paluajtshme ka ndërruar jetë.

3. Përjashtimisht, në rastet e parashikuara në pikën 5 të nenit 22 të këtij ligji, ministri vendos vetë nëse është kryer shkelje dhe jep masën disiplinore përkatëse.

Neni 28

Parimet e procedimit disiplinor

1. Masat disiplinore merren sipas një procedure transparente dhe në përputhje me të drejtën për një proces të rregullt ligjor, e cila garanton të drejtën për t'u informuar, për të kërkuar sqarime rreth fakteve, për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur.

2. Palët në procedim disiplinor kanë të drejtë të paraqiten e të japin shpjegime në seancë vetë ose nëpërmjet përfaqësimit me të tretë. Nëse njëra ose të dyja palët nuk paraqiten në seancë pa shkaqe të arsyeshme, komisioni disiplinor e shqyrton çështjen dhe merr vendim në mungesë të tyre.

Neni 29

Komisioni disiplinor

1. Komisioni disiplinor është organ kolegjal, i cili përbëhet nga:

a) 2 përfaqësues nga ministria;

b) 1 përfaqësues nga ministria që mbulon çështjet e parandalimit të pastrimit të parave;

c) 2 përfaqësues nga shoqatat profesionale të ndërmjetësve të pasurive të paluajtshme.

2. Kryetari dhe anëtarët e komisionit disiplinor zgjidhen për një mandat katërvjeçar me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

3. Rregullat e hollësishme për kriteret, procedurat për përzgjedhjen e përfaqësuesve dhe funksionimin e komisionit disiplinor, për mënyrën e ushtrimit të përgjegjësiave prej tij dhe për organizimin e procedimit disiplinor përcaktohen me urdhër të ministrit.

4. Masa e shpërblimit të anëtarëve të komisionit disiplinor caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas rregullave të përcaktuara për shpërblimin e anëtarëve të organeve kolegjiale.

Neni 30

Pezullimi i procedimit disiplinor

Rregullat për pezullimin e hetimit disiplinor, sipas nenit 26 të këtij ligji, zbatohen për atë që është e mundur për pezullimin e procedimit disiplinor.

Neni 31

Vendimarrja e komisionit disiplinor për çështjet disiplinore

Pas shqyrtimit të të gjitha fakteve dhe provave, komisioni disiplinor vendos:

a) rrëzimin e kërkesës për procedim disiplinor për shkak se faktet e pretenduara nuk kanë ndodhur ose nuk përbëjnë shkelje disiplinore; ose

b) pranimin e plotë ose të pjesshëm të kërkesës nëpërmjet marrjes së një ose më shumë masave disiplinore.

Neni 32

Regjistrimi i masave disiplinore

1. Ministria shënon në Regjistrin e Ndërmjetësve të Pasurive të Paluajtshme vendimet për masat disiplinore.



2. Masat disiplinore shuhen dhe fshihen nga regjistri kur:

- a) ka kaluar 1 vit nga vendosja e masës disiplinore të paralajmërimit me shkrim;
- b) kanë kaluar 2 vjet nga pagesa e gjobës;
- c) kanë kaluar 3 vjet nga data e ekzekutimit të masës disiplinore të pezullimit të përkohshëm të ushtrimit të veprimtarisë.

3. Masa disiplinore e heqjes së certifikatës së ushtrimit të profesionit të ndërmjetësit nuk shuhet dhe nuk fshihet nga regjistri.

4. Në rastin e vendimit për heqjen e certifikatës së ushtrimit të profesionit dhe çregjistrimin nga Regjistri i Ndërmjetësve të Pasurive të Paluajtshme, respektivisht, nga ministri, sipas shkronjës “ë” të pikës 1 të nenit 36, apo të pikës 2 të nenit 36 të këtij ligji, ose nga komisioni disiplinor sipas shkronjës “dh” të pikës 2 të nenit 22 të këtij ligji, ministri urdhëron njoftimin e vendimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Neni 33

E drejta e ankimit për masat disiplinore

1. Kundër urdhrit të ministrit ose vendimit të komisionit disiplinor për dhënien e masave disiplinore, ndërmjetësi i pasurive të paluajtshme mund të paraqesë padi në gjykatën administrative kompetente brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

2. Paraqitja e padisë në gjykatë kundër urdhrit të ministrit ose vendimit të komisionit disiplinor nuk pezullon zbatimin e urdhrit ose të vendimit të ankimuar derisa vendimi gjyqësor për ankimin të marrë formë të prerë.

Neni 34

Ekzekutimi i vendimit

1. Ministria mbikëqyr zbatimin e masave që vendosen në përfundim të procedimit disiplinor.

2. Kur masa disiplinore merret nga komisioni disiplinor, ministri urdhëron regjistrimin e vendimit në Regjistrin e Ndërmjetësve të Pasurive të Paluajtshme dhe kryerjen e çdo veprimi tjetër të nevojshëm për zbatimin e masës.

3. Ministria zbaton masat disiplinore:

a) brenda 1 muaji për masat disiplinore të parashikuara nga shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç” të pikës 2 të nenit 22 të këtij ligji;

b) brenda 2 javëve për masat disiplinore të parashikuara nga shkronjat “d” dhe “dh” të pikës 2 të nenit 22 të këtij ligji.

KREU VII

PEZULLIMI, HEQJA E CERTIFIKATËS DHE ÇREGJISTRIMI I NDËRMJETËSVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME

Neni 35

Pezullimi i certifikatës së ndërmjetësit

1. Ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme mund t'i pezullohet përkohësisht certifikata nga ministri kur:

a) merr cilësinë e të pandehurit ose është në gjykim për njërën nga veprat penale në fushën e pastrimit të parave, të financimit të terrorizmit apo të armëve të shkatërrimit në masë;

b) ndaj tij ka filluar një procedurë për çregjistrim nga Regjistri i Ndërmjetësve të Pasurive të Paluajtshme kur ka dyshime të arsyeshme se certifikimi është bërë në kundërshtim me kriteret dhe kushtet e parashikuara në këtë ligj;

c) ndaj tij ka filluar një procedurë për heqjen e zotësisë juridike për të vepruar;

ç) i kufizohet zotësia juridike për të vepruar me vendim gjyqësor të formës së prerë;

d) vendoset për pranimin e kërkesës së autoritetit përgjegjës për pezullimin e certifikatës të ndërmjetësit në përputhje me pikën 2 të nenit 36 të këtij ligji.

2. Pezullimi, sipas pikës 1 të këtij neni, zgjat për aq kohë sa ekzistojnë arsyet për të cilat është urdhëruar pezullimi.

3. Kundër vendimit të ministrit, ndërmjetësi i pasurive të paluajtshme ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatën kompetente në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Neni 36

Heqja e certifikatës dhe çregjistrimi nga Regjistri i Ndërmjetësve të Pasurive të Paluajtshme

1. Ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme i hiqet certifikata e ushtrimit të profesionit të ndërmjetësit nga ministri dhe çregjistrohet nga



Regjistri i Ndërmjetësve të Pasurive të Paluajtshme në rastet kur:

a) heq dorë me kërkesën e tij nga ushtrimi i profesionit të ndërmjetësve të pasurive të paluajtshme;

b) humbet zotësinë juridike për të vepruar me vendim gjyqësor të formës së prerë;

c) dënohet me një vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi që dënohet në maksimum jo më pak se 10 vjet ose për kryerjen e veprave penale në fushën e pastrimit të parave, të financimit të terrorizmit apo të armëve të shkatërrimit në masë, si dhe veprave penale në fushën e mashtrimeve;

ç) ndaj tij jepet masa disiplinore e heqjes së certifikatës së ushtrimit të profesionit;

d) vërtetohet se në momentin e marrjes së certifikatës, e ka marrë atë në kundërshtim me kriteret ligjore të parashikuara në legjislacionin në fuqi;

dh) vendoset për pranimin e kërkesës së autoritetit përgjegjës për heqjen e certifikatës së ndërmjetësit në përputhje me pikën 2 të këtij neni;

e) humb jetën;

ë) në çdo rast tjetër që parashikohet nga ky ligj.

2. Me kërkesë të autoritetit përgjegjës, ministri mund të pezullojë ose të heqë certifikatën e një ndërmjetësi të pasurive të paluajtshme në përputhje me nenin 26 të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar. Në çdo rast, ministri, përpara se të vendosë pezullimin ose heqjen e certifikatës së ndërmjetësit, shqyrton kërkesën e autoritetit përgjegjës në përputhje me parimet e përcaktuara në nenin 28 të këtij ligji. Kundër vendimit të ministrit, ndërmjetësi i pasurive të paluajtshme mund të paraqesë padë në gjykatën administrative kompetente, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Neni 37

Penalitetet

1. Cilido që kryen veprime juridike me pasuritë e paluajtshme, në kuptim të këtij ligji, pa qenë i pajisur me certifikatën përkatëse, ose nuk vepron në përputhje me parashikimet e nenit 39 të këtij ligji, ndëshkohet me masë administrative me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 500 000

(pesëqind mijë) lekë në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.

2. Gjoha e vendosur kundër subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e ndërmjetësimit të pasurive të paluajtshme sipas pikës 1 të këtij neni, arkëtohet në buxhetin e shtetit.

KREU VIII

DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 38

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet ministri që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 6, pika 3; nenit 8, pika 8; nenit 9, pika 4; nenit 11, pika 4; nenit 12, pika 5; nenit 21, pika 6; nenit 23, pika 4; nenit 29, pika 3, të këtij ligji.

2. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktin nënligjor në zbatim të pikës 4 të nenit 29 të këtij ligji.

Neni 39

Dispozita kalimtare

1. Të gjitha subjektet që kanë të paktën 12 muaj që ushtrojnë veprimtarinë e ndërmjetësimit të pasurive të paluajtshme nga data e hyrjes në fuqi e këtij ligji, konsiderohen *ipso lege* të certifikuara për ushtrimin e veprimtarisë së ndërmjetësimit të pasurive të paluajtshme në rast se plotësojnë kriteret e parashikuara nga shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d” të pikës 1, si dhe pikat 2 dhe 3 të nenit 8 të këtij ligji. Ministri, urdhëron regjistrimin e këtyre subjekteve në Regjistrin e Ndërmjetësve të Pasurive të Paluajtshme kur plotësohen njëkohësisht kushtet e mëposhtme:

a) janë regjistruar si persona fizikë ose juridikë apo të punësuar si ndërmjetës të pasurive të paluajtshme nga një person fizik ose juridik, që ushtron rregullisht veprimtarinë tregtare në këtë fushë, sipas parashikimeve të legjislacionit tregtar e tatimor në fuqi;

b) subjektet ushtrojnë rregullisht veprimtarinë tregtare në fushën e ndërmjetësimit për jo më pak se 12 muaj nga data e hyrjes në fuqi e këtij ligji;



c) plotësojnë kriteret e parashikuara nga shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d” të pikës 1 të nenit 8 të këtij ligji; si dhe

ç) Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave nuk ka asnjë të dhënë për përfshirjen e subjektit ose personat e lidhur me të në pastrimin e parave, financimin e terrorizmit apo të armëve të shkatërrimit në masë.

2. Të gjitha subjektet që kanë më pak se 12 muaj që ushtrojnë veprimtarinë e ndërmjetësimit të pasurive të paluajtshme, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, vijojnë të ushtrojnë aktivitetin e tyre, si dhe kanë detyrimin për të ndjekur programin e detyrueshëm të trajnimit brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Ministri urdhëron regjistrimin e këtyre subjekteve në Regjistrin e Ndërmjetësve të Pasurive të Paluajtshme kur plotësohen njëkohësisht kushtet e mëposhtme:

a) janë regjistruar si persona fizikë ose juridikë apo të punësuar si ndërmjetës të pasurive të paluajtshme nga një person fizik ose juridik, që ushtron rregullisht veprimtarinë tregtare në këtë fushë, sipas parashikimeve të legjislacionit tregtar dhe tatimor në fuqi;

b) subjektet ushtrojnë rregullisht veprimtarinë tregtare në fushën e ndërmjetësimit për më pak se 12 muaj nga data e hyrjes në fuqi e këtij ligji;

c) plotësojnë kriteret e parashikuara nga shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d” të pikës 1 të nenit 8 të këtij ligji;

ç) përfundojnë programin e detyrueshëm të trajnimit; si dhe

d) Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave nuk ka asnjë të dhënë për përfshirjen e subjektit ose të personave të lidhur me të në pastrimin e parave, financimin e terrorizmit apo të armëve të shkatërrimit në masë.

3. Brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të gjitha subjektet, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, paraqesin kërkesë pranë ministrit për regjistrimin e tyre në Regjistrin e Ndërmjetësve të Pasurive të Paluajtshme, duke paraqitur të gjitha të dhënat e kërkuara për pasqyrimin e tyre në regjistrin përkatës, si dhe të gjithë informacionin e nevojshëm që vërteton ushtrimin e rregullt të veprimtarisë, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni. Në rast se subjekti nuk paraqet kërkesë brenda këtij afati, nuk lejohet të ndërmjetësojë kryerjen e veprimeve juridike për kalimin e pasurive të paluajtshme ose të

të drejtave reale mbi to, pavarësisht formës ose mjetit që përdoret për ndërmjetësimin.

4. Ministri, pas marrjes së kërkesës së subjektit për regjistrimin në Regjistrin e Ndërmjetësve të Pasurive të Paluajtshme, i kërkon Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave të verifikojë përfshirjen e tyre në pastrimin e parave, financimin e terrorizmit apo të armëve të shkatërrimit në masë. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave është e detyruar të verifikojë dhe të njoftojë ministrin jo më vonë se 30 ditë nga data e marrjes së kërkesës për ekzistencën e çdo informacioni për përfshirjen e subjektit në pastrimin e parave, financimin e terrorizmit apo të armëve të shkatërrimit në masë.

5. Kur subjekti plotëson kushtet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, ministri lëshon certifikatën përkatëse për ushtrimin e veprimtarisë së ndërmjetësimit për pasuritë e paluajtshme dhe i regjistron ato në Regjistrin e Ndërmjetësve të Pasurive të Paluajtshme. Në rast se Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave ka në administrim të dhëna për përfshirjen e subjektit në pastrimin e parave, financimin e terrorizmit apo të armëve të shkatërrimit në masë ose subjekti nuk vërteton përmbushjen e kushteve të përcaktuara pikën 1 ose 2 të këtij neni, ministri refuzon kërkesën për regjistrimin e subjektit në Regjistrin e Ndërmjetësve të Pasurive të Paluajtshme.

6. Kundër vendimit të ministrit për mosregjistrim në regjistrin përkatës mund të bëhet ankim në gjykatën kompetente sipas legjislacionit procedural në fuqi.

7. Rregullat e hollësishme për paraqitjen dhe kërkesën për regjistrimin në Regjistrin e Ndërmjetësve të Pasurive të Paluajtshme, si dhe për verifikimin e plotësimin të kriterëve ligjorë në përputhje me parashikimet e këtij neni përcaktohen me urdhër të ministrit.

Neni 40

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar më datë 27.1.2022.



LIGJ
Nr. 10/2022

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 9863, DATË 28.1.2008,
“PËR USHQIMIN”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 11 pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Për sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve hartohet Strategjia Kombëtare e Sigurisë Ushqimore, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Kjo strategji rishikohet çdo 7 vjet.”.

Neni 2

Në nenin 16 bëhen ndryshimi dhe shtesat si më poshtë:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Kontrolli i përputhshmërisë së dokumentacionit shoqërues, sipas nenit 18 të këtij ligji, të ngarkesave të ushqimeve të importuara me kërkesat e legjislacionit shqiptar kryhet në Pikat e Inspektimit Kufitar nga inspektori i institucionit përgjegjës të kontrollit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë. Inspektori vendos bllokimin e ngarkesës dhe masa të tjera të parashikuara në këtë ligj ose në aktet nënligjore në zbatim të tij kur dokumentacioni shoqërues nuk është në përputhje me kërkesat ligjore.”.

2. Pas pikës 3 shtohen pikat 4 dhe 5 me këtë përmbajtje:

“4. Në rast të marrëveshjeve ndërkombëtare dypalëshe ose shumëpalëshe kontrolli i përcaktuar

në pikat 1 dhe 2 të këtij neni mund të kryhet sipas parashikimeve të përcaktuara në marrëveshje.

5. Rregullat dhe procedurat e kryerjes së kontrollit zyrtar sipas këtij neni përcaktohen me udhëzim të ministrit.”.

Neni 3

Në nenin 17 bëhen shtesa dhe ndryshimi si më poshtë:

1. Në pikën 1 pas fjalisë së parë shtohet fjalia e dytë me këtë përmbajtje:

“Në rastin e pikës 4 të nenit 16 të këtij ligji procedurat doganore kryhen pasi inspektori i ushqimit dhe ushqimit për kafshë jep miratimin.”.

2. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Shpenzimet për kontrollin zyrtar, për marrjen e mostrës dhe kryerjen e analizave laboratorike përballohen nga importuesi, me përjashtim të parashikimeve të marrëveshjeve ndërkombëtare dypalëshe ose shumëpalëshe me vendet eksportuese, ku në kushte reciprociteti mund të mos aplikohen tarifa.”.

Neni 4

Në nenin 38 paragrafi i tretë ndryshohet si më poshtë:

“Tarifat për marrjen e mostrave, kryerjen e analizave, kontrollin zyrtar në PIK dhe për pajisjen me dokumentin që vërteton sigurinë e ushqimeve miratohen me udhëzim të ministrit. Në rast të marrëveshjeve ndërkombëtare dypalëshe ose shumëpalëshe zbatohen dispozitat e marrëveshjeve, dhe në kushte reciprociteti mund të mos aplikohen tarifa.”.

Neni 5

Në nenin 51 pas pikës 6 shtohen pikat 7 dhe 8 me këtë përmbajtje:

“7. Parashikimet e pikës 4 të nenit 16 të këtij ligji për kontrollin dhe pikës 1/1 të nenit 17 të këtij ligji për procedurat doganore aplikohen edhe në importin e ushqimit për kafshë. Shpenzimet për kontrollin zyrtar për ushqimin për kafshë, marrjen e mostrës dhe kryerjen e analizave laboratorike përballohen nga importuesi, me përjashtim të detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe me vendet eksportuese.



8. Procedurat e kryerjes së kontrollit zyrtar përcaktohen me udhëzim të ministrit.”.

Neni 6
Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 8 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të nenit 1 të tij.

2. Ngarkohet ministri që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 2 dhe 5 të tij.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar ë datë 27.1.2022.

Shpallur me dekretin nr. 13478, datë 16.2.2022, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

DEKRET
Nr. 13478, datë 16.2.2022

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 10/2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9863, datë 28.1.2008, ‘Për ushqimin’, të ndryshuar”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

LIGJ
Nr. 11/2022

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 10 465, DATË 29.9.2011,
“PËR SHËRBIMIN VETERINAR NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës me propozimin e një deputeti,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 4, pika 6, në fund të fjalisë shtohen fjalët “dhe në doganë jashtë PIK-ut”.

Neni 2

Në nenin 33 pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1.1. Në rastin e marrëveshjeve ndërkombëtare dypalëshe ose shumëpalëshe, kontrolli veterinar i ngarkesave sipas pikës 1 të këtij neni kryhet në doganën e vendit/pikës së destinacionit të ngarkesës.”.

Neni 3

Në nenin 34 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

1. Titulli i nenit ndryshohet si më poshtë:

“Ngarkimi, ringarkimi, shkarkimi dhe magazinimi i kafshëve të gjalla që importohen, tranzitohen ose eksportohen”.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Inspektimet e detyrueshme sanitaro-veterinare për ngarkimin, ringarkimin, shkarkimin, magazinimin dhe përpunimin e ngarkesave në PIK ose në doganën e vendit/pikës së destinacionit të



ngarkesës kryhen në zbatim të dispozitave të marrëveshjeve ndërkombëtare dypalëshe ose shumëpalëshe.”.

3. Në pikën 3 pas fjalëve “në PIK” shtohen fjalët “dhe në doganën jashtë PIK-ut.”.

Neni 4

Në nenin 35 bëhen shtesat dhe ndryshimi si më poshtë:

1. Në pikën 1 pas fjalës “PIK” shtohen fjalët “ose në doganën e vendit/pikës së destinacionit”.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Importuesi kryen procedurat e përcaktuara për lajmërimin paraprak të ngarkesës, përcaktimin e vendit/pikës së destinacionit, paraqitjen e ngarkesës për kontroll në PIK ose doganën e vendit/pikës së destinacionit në rastin e marrëveshjeve ndërkombëtare dypalëshe ose shumëpalëshe, si dhe për pagesën e tarifës së kontrollit veterinar. Në çdo rast importuesi do të zbatojë masat e vendosura nga inspektori veterinar që kryen kontrollin e ngarkesave të importuara, të përcaktuara në këtë kre.”.

Neni 5

Në nenin 36 bëhen ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

1. Titulli i nenit ndryshohet si më poshtë:

“Kontrolli i ngarkesave në PIK dhe në doganën e pikës/vendit të destinacionit”.

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Në rast të marrëveshjeve ndërkombëtare dypalëshe ose shumëpalëshe, kontrolli për ngarkesat e përfshira në marrëveshje do të kryhet sipas parashikimeve të përcaktuara në marrëveshje.”.

Neni 6

Në nenin 37 pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Në rastin e marrëveshjeve ndërkombëtare dypalëshe ose shumëpalëshe, vetëm për ngarkesat e përcaktuara në nenin 33, pika 1, të këtij ligji, referuar marrëveshjes, në PIK do të kryhet vetëm kontrolli i dokumentacionit.”.

Neni 7

Në nenin 38 në pikën 1 pas fjalisë së parë shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Inspektimit veterinar në PIK nuk i nënshtrohen ngarkesat e përcaktuara në marrëveshje që vijnë nga vendi apo vende me të cilat ka marrëveshje për kryerjen e kontrollit veterinar në doganën e vendit/pikës së destinacionit.”.

Neni 8

Në nenin 39 pas pikës 3 shtohen pikat 4 dhe 5 me këtë përmbajtje:

“4. Në rastin e marrëveshjeve ndërkombëtare dypalëshe ose shumëpalëshe për kryerjen e kontrollit veterinar në doganën e vendit/pikës së destinacionit, inspektori veterinar i Autoritetit kompetent për PIK, në rast se dyshon për sëmundje infektive, ndotje, ndryshime organoleptike të mallit apo mangësi të kontrollit fizik, urdhëron:

a) zbatimin e masave karantinore të përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore;

b) rikontrollin veterinar me analiza laboratorike të specifikuara;

c) kthimin mbrapsht të ngarkesës sipas nenit 40 të këtij ligji;

ç) konfiskimin, eliminimin dhe asgjësimin në mënyrë të sigurt në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Për masat e marra sipas pikës 4 të këtij neni, inspektori mban procesverbalin e inspektimit dhe njofton menjëherë strukturën përgjegjëse për veterinarinë në ministri dhe autoritetin kompetent. Shpenzimet për masat e marra në këtë rast mbulohen nga pronari ose subjekti përgjegjës për ngarkesën.”.

Neni 9

Në nenin 85 pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Certifikata e tregtimit të PMV-së së regjistruar nënshkruhet nga drejtori përgjegjës për veterinarinë në ministri brenda 10 ditëve kalendarike pas paraqitjes së pagesës së tarifës nga kërkuesi.”.



Neni 10

Në nenin 88, pika 1, shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

“b) një përfaqësues nga instituti përgjegjës për kryerjen e analizave të sigurisë ushqimore dhe veterinarë dhe një nga autoriteti kompetent i ngritur sipas këtij ligji.”.

Neni 11

Neni 89 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 89

Vendimet e Komisionit

1. Komisioni merr vendim me shumicë votash:

a) për pranimin ose refuzimin e kërkesës për tregtim të PMV-ve, mbështetur në rregulloren përkatëse për produktet, të miratuar në zbatim të këtij ligji;

b) çregjistrimin e certifikatave për tregtim të PMV-ve të regjistruara për produkte që nuk kanë certifikatë tregtimi nga një prej vendeve të BE-së ose të lëshuara nga EMA, ose janë regjistruar në kundërshtim me ligjin.

2. Produktet e importuara, certifikata e të cilave çregjistrohet, tregtohen sipas rregullores përkatëse të miratuar në zbatim të këtij ligji.

3. Kundër vendimeve të komisionit bëhet ankim në gjykatë brenda 45 ditëve kalendarike nga marrja dijeni e vendimit.”.

Neni 12

Në nenin 91 pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

“6. Certifikata e tregtimit të PMV-ve humbet vlefshmërinë menjëherë me mbarimin e vlefshmërisë së tregtimit në një nga vendet e BE-së ose EMA-s. SPV-ja i propozon Komisionit marrjen e vendimit të çregjistrimit në mbledhjen e parë pas njoftimit nga BE-ja.”.

Neni 13

Në nenin 120 në pikën 3 fjala “urdhër” zëvendësohet me fjalën “udhëzim”.

Neni 14

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar më datë 27.1.2022.

Shpallur me dekretin nr. 13479, datë 16.2.2022, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

DEKRET

Nr. 13479, datë 16.2.2022

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 11/2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10465, datë 29.9.2011, Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

DEKRET

Nr. 13480, datë 17.2.2022

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 13, 14, 20 dhe në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Erjola Shkelqim Elezaj
2. Faviol Mhill Marku
3. Klesta Vlerar Gjylbegaj



4. Antoneta Kostaq Hauner (Bushit)
5. Megi Agim Poçka
6. Artan Dilaver Manjani
7. Silda Ylli Koçi (Koci) (Osmanaj)
8. Najada Mehmet Stringa
9. Massimo Edi Demo
10. Sidorela Qamil Mirashi (Xhahollari)
11. Marina Çedo Çullafiq
12. Anjeza Kujtim Mema
13. Rilinda Tajar Çala (Cala)
14. Vasilika Ilir Gaçe
15. Klotilda Kujtim Vasilja (Dushku)
16. Erjona Piro Grabocka
17. Livia Bujar Puja (Titze)
18. Marsel Alket Shyti
19. Kevin Bardhyl Belegu

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

URDHËR**Nr. 29, datë 1.2.2022**

**PËR MIRATIMIN E PËRKTHIMIT NË
GJUHËN SHQIPE TË NDRYSHIMEVE
NË STANDARDIN NDËRKOMBËTAR TË
RAPORTIMIT FINANCIAR (SNRF) 17
“KONTRATAT E SIGURIMIT”**

Në mbështetje të nenit 3, pika 4 dhe pika 5, të ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 17.7.2019, “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e ndryshimeve në Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar (SNRF) 17 “Kontratat e sigurimit”.

2. Ndryshimet e SNRF 17 “Kontratat e sigurimit”, të publikuara në dhjetor 2021, kanë dalë efektive pas 1 janar 2023.

3. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

**MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj**



Zbatimi për herë të parë i SNRF 17 dhe SNRF 9 – Informacioni krahasues

Ndryshime në SNRF 17

Ndryshime në SNRF 17 *Kontratat e sigurimit*

Janë shtuar paragrafët C2A, C28A–C28E, C33A, si dhe një titull para paragrafit C28A. Për lehtësi leximi këta paragrafë nuk janë nënvizuar. Paragrafi C29 nuk është ndryshuar, por është përfshirë në tekst me ngjyrën gri për lehtësi referimi.

Shtojca C

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

...

Data e hyrjes në fuqi

...

- C2A Zbatimi për herë të parë i SNRF 17 dhe i SNRF 9 – Informacioni krahasues, i publikuar në dhjetor 2021, shtoi paragrafët C28A–C28E dhe C33A. Njësia ekonomike që zgjedh të zbatojë paragrafët C28A–C28E dhe C33A duhet t'i zbatojë ato në aplikimin fillestar të SNRF 17.

Periudha kalimtare

...

Informacioni krahasues

...

Njësitet ekonomike që zbatojnë njëkohësisht për herë të parë SNRF 17 dhe SNRF 9

- C28A Njësia ekonomike që zbaton njëkohësisht për herë të parë SNRF 17 dhe SNRF 9 lejohet të zbatojë paragrafët C28B–C28E (mbivendosje në klasifikim), me qëllim paraqitjen e informacionit krahasues mbi një aktiv financiar, nëse informacioni krahasues për atë aktiv financiar nuk është riparaqitur sipas SNRF 9. Informacioni krahasues për një aktiv financiar nuk do të riparaqitet sipas SNRF 9 nëse njësia ekonomike zgjedh të mos riparaqesë periudhat e mëparshme (shih paragrafin 7.2.15 të SNRF 9), ose nëse njësia ekonomike riparaqet periudhat e mëparshme, por aktivi financiar është çregjistruar gjatë atyre periudhave të mëparshme (shih paragrafin 7.2.1 të SNRF 9).
- C28B Një njësi ekonomike që zbaton mbivendosjen në klasifikim të një aktivi financiar, duhet të paraqesë informacion krahasues sikur kërkesat e SNRF 9 për klasifikimin dhe matjen të ishin zbatuar për atë aktiv financiar. Njësia ekonomike duhet të përdorë informacionin e arsyeshëm dhe mbështetës në dispozicion në datën e tranzicionit (shih paragrafin C2(b)) për të përcaktuar sesi njësia ekonomike pret që aktivi financiar do të klasifikohet dhe matet në zbatimin fillestar të SNRF 9 (për shembull, njësia ekonomike mund të përdorë vlerësimet paraprake të kryera më parë për t'u përgatitur për zbatimin fillestar të SNRF 9).
- C28C Kur zbatohet mbivendosja në klasifikimin e një aktivi financiar, nuk kërkohet që njësia ekonomike të zbatojë kërkesat për zhvlerësim të seksionit 5.5 të SNRF 9. Nëse bazuar në klasifikimin e përcaktuar sipas zbatimit të paragrafit C28B, aktivi financiar do të jetë objekt i kërkesave për zhvlerësim të seksionit 5.5 të SNRF 9, por njësia ekonomike nuk i zbaton ato kërkesa duke zbatuar mbivendosjen në klasifikim, njësia do të vazhdojë të paraqesë çdo shumë të njohur në lidhje me zhvlerësimin në periudhat e mëparshme, në përputhje me SNK 39 *Instrumentet financiare – Njohja dhe matja*. Përndryshe, shumat të tilla do të anulohen.
- C28D Çdo diferencë mes vlerës kontabël (neto) të mëparshme të aktivit financiar dhe vlerës kontabël (neto) në datën e tranzicionit që vjen nga zbatimi i paragrafëve C28B–C28C do të njihet në çeljen e fitimeve të pashpërndara (ose të një përbërësi tjetër të kapitalit neto, si të jetë më e përshtatshme) në datën e tranzicionit.



C28E Njësia ekonomike që zbaton paragrafët C28B–C28D, do të:

- a) japë informacion shpjegues cilësor që u mundëson përdoruesve të pasqyrave financiare të kuptojnë:
 - i. madhësinë e zbatimit të mbivendosjes në klasifikim (për shembull, nëse është zbatuar për të gjithë aktivet financiare të panjohura në periudhën krahasuese);
 - ii. nëse dhe deri në ç'masë janë zbatuar kërkesat për zhvlerësim të seksionit 5.5 të SNRF 9 (shih paragrafin C28C);
- b) zbatojë këta paragrafë vetëm për informacionin krahasues për periudhat e raportimit mes datës së tranzicionit në SNRF 17 dhe datës së zbatimit fillestar të SNRF 17 (shih paragrafët C2 dhe C25); dhe
- c) zbatojë kërkesat kalimtare të SNRF 9 (shih seksionin 7.2 të SNRF 9) në datën e zbatimit fillestar të SNRF 9.

Riklasifikimi i aktiveve financiare

C29 Në datën e zbatimit fillestar të SNRF 17, njësia ekonomike që ka zbatuar SNRF 9 për periudhat vjetore të raportimit para zbatimit fillestar të SNRF 17:

- a) mund të rivlerësojë nëse një aktiv financiar i përshtatshëm plotëson kushtet në paragrafin 4.1.2(a) ose paragrafin 4.1.2A(a) të SNRF 9. Një aktiv financiar është i përshtatshëm vetëm nëse aktivi financiar nuk mbahet i lidhur me një aktivitet që është i palidhur me kontratat brenda objektit të SNRF 17. Shembuj të aktiveve financiare, që nuk do të jenë të pranueshme për rivlerësim, janë ato aktive të mbajtura në lidhje me aktivitetet bankare ose aktivet financiare të mbajtura në fonde që kanë të bëjnë me kontratat e investimeve që janë jashtë objektit të SNRF 17;
- b) do të anulojë përcaktimin e saj të mëparshëm të një aktivi financiar si të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes nëse kushti në paragrafin 4.1.5 të SNRF 9 nuk përmbushet më si rezultat i zbatimit të SNRF 17;
- c) mund të caktojë një aktiv financiar si të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes nëse plotësohet kushti në paragrafin 4.1.5 të SNRF 9;
- d) mund të caktojë një investim në instrument kapitali neto si një instrument me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse në përputhje me paragrafin 5.7.5 të SNRF 9;
- e) mund të anulojë përcaktimin e tij të mëparshëm për një investim në instrument kapitali neto si një instrument me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse në përputhje me paragrafin 5.7.5 të SNRF 9.

...

C33A Për një aktiv financiar të çregjistruar mes datës së tranzicionit dhe datës së zbatimit fillestar të SNRF 17, njësia ekonomike mund të zbatojë paragrafët C28B–C28E (mbivendosja në klasifikim) me qëllim paraqitjen e informacionit krahasues sikur paragrafi C29 të ishte zbatuar ndaj atij aktivi. Njësia ekonomike, në këtë rast do të përshtatë kërkesat e paragrafëve C28B–C28E që mbivendosja në klasifikim të bazohet në pritshmërinë e njësisë, për përcaktimin e aktivitetit financiar sipas paragrafit C29, në datën e zbatimit fillestar të SNRF 17.

**URDHËR****Nr. 126, datë 18.2.2022****PËR DELEGIM KOMPETENCASH**

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 11/b, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”; të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; si dhe të nenit 11, pikave 2 dhe 3, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, z. Endrit Musaj, drejtor i Inspektimit dhe Trajnimeve, për shkak të mungesës me arsye të titullarit të këtij institucioni.

2. Kompetencat e drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave do të ushtrohen për periudhën nga data 21.2.2022 deri në datën 28.2.2022.

3. Nuk delegohen kompetencat e drejtuesit lidhur me personelin, si dhe kompetencat e tjera të padelegueshme, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

4. Për veprimet e kryera, në zbatim të këtij urdhri, drejtori i Inspektimit dhe Trajnimeve do të ruajë kopje të kartelave shoqëruese të praktikave shkresore, të iniciuara apo të përfunduara prej tij, së bashku me afatet e përcaktuara dhe ecurinë e mbarëvajtjes e çështjeve, dhe do t’ia bëjë të ditura titullarit me rikthimin e tij në detyrë.

5. Për zbatimin e urdhrit ngarkohet drejtori i Inspektimit dhe Trajnimeve, z. Endrit Musaj.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM**Ardit Bido****NJOFTIM****Nr. 2117, datë 17.2.2022****MBI HYRJEN NË FUQI TË
MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE**

1. “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për lehtësimin e procedurave dhe kushteve për marrjen e leje qëndrimit të përkohshme”, ka hyrë në fuqi më 8 shkurt 2022.

2. “Marrëveshja ndryshuese e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për hapjen e pikës së përbashkët të kalimit kufitar Krushevë (Dragash)–Shishtavec (Kukës)”, ka hyrë në fuqi më 11 shkurt 2022.

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT
E JASHTME
Armand Skapi**

VENDIM**Nr. 18, datë 4.2.2022****MBI DEPOZITIMIN NGA OPERATORI I
SISTEMIT TË SHPËRNDARJES (OSSH
SHA) PËR MIRATIM NË ERE TË
KONTRATËS PËR OFRIMIN E
SHËRBIMEVE TË ZYRTARIT TË
PAJTUESHMËRISË DHE KRITEREVE
PËR PËRZGJEDHJEN E TIJ**

Në mbështetje të nenit 3, pika 93, nenit 16 dhe nenit 72, pika 3, germa “b”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; si dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; pikës 1.2 dhe pikës 2 të Programit të Pajtueshmërisë së OSSH sh.a.; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.2.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 179 prot., datë 26.1.2022, të përgatitur nga drejtoritë teknike, “Mbi depozitimin nga ana e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a. për miratim në ERE të kontratës për ofrimin e



shërbimeve të zyrtarit të pajtueshmërisë dhe kritereve për përzgjedhjen e tij”,

konstatohet se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 257, datë 21.12.2020, ka miratuar Programin e Pajtueshmërisë të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a.

- ERE ka njoftuar për këtë vendimmarrje OSSH sh.a. dhe palët e tjera të interesit nëpërmjet shkresës nr. 1326 prot., datë 31.12.2020.

- Në pikën 1.2 dhe pikën 2 të Programit të Pajtueshmërisë së OSSH sh.a., miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 257/2021, përcaktohet si vijon:

1.2 Në kuadër të Programit të Pajtueshmërisë OSSH sh.a. përcakton: zyrtarin e pajtueshmërisë, i cili ngarkohet me monitorimin e përhershëm dhe të vazhdueshëm dhe raportimin pranë ERE-s mbi zbatimin e Programit, sidomos në nivelin e zbatueshmërisë dhe efektshmërisë së tij.

2. Me vendim të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë caktohet zyrtari i pajtueshmërisë, i cili është përgjegjës për të siguruar pajtueshmërinë, si dhe paraqitjen e Raportit të Pajtueshmërisë pranë ERE-s.

- OSSH sh.a. nuk ka përcaktuar ende zyrtarin e pajtueshmërisë, i cili miratohet më pas me vendim të Bordit të ERE-s.

- Mospërcaktimi i zyrtarit të pajtueshmërisë së OSSH sh.a., është evidentuar dhe nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (ref. Compliance Note CN 02/21, datë 22 nëntor 2021), i cili në paragrafin 3.2.5 shprehet se OSSH sh.a. duhet të emërojë një zyrtar pajtueshmërie pas miratimit të Programit të Pajtueshmërisë nga ERE.

- Për të vijuar me procedurën e caktimit/miratimit të zyrtarit të pajtueshmërisë, OSSH sh.a., pas miratimit nga organet drejtuese të saj dhe brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune duhet të depozitojë për miratim në ERE:

- kontratën për ofrimin e shërbimeve të zyrtarit të pajtueshmërisë;

- kriteret minimale, kriteret profesionale dhe kriteret e tjera përzgjedhëse për zyrtarin e pajtueshmërisë, të cilat do t'i bashkëlidhen kontratës, si pjesë integrale e saj;

- brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga miratimi në ERE i kontratës për ofrimin e shërbimeve dhe kritereve të përzgjedhjes, Operatori i Sistemit të

Shpërndarjes (OSSH) sh.a., të përcjellë për miratim në ERE zyrtarin e pajtueshmërisë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., pas miratimit nga organet drejtuese të shoqërisë, të përcjellë për miratim në ERE kontratën për ofrimin e shërbimeve të zyrtarit të pajtueshmërisë dhe kriteret minimale, kriteret profesionale, si dhe kriteret e tjera përzgjedhëse për zyrtarin e pajtueshmërisë, të cilat do t'i bashkëlidhen kontratës, si pjesë integrale e saj.

2. Propozimet e OSSH sh.a., sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi të dërgohen në ERE brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune.

3. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga miratimi në ERE i kontratës për ofrimin e shërbimeve dhe kritereve të përzgjedhjes, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., të përcjellë për miratim në ERE zyrtarin e pajtueshmërisë.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë OSSH sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendrike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendrike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM

Nr. 19, datë 4.2.2022

**MBI SHTYRJEN E VENDIMMARRJES
SË BORDIT, PËR KËRKESËN E
SHOQËRISË “HERA” SHPK, PËR
TRANSFERIMIN E PLOTË TË
LICENCËS NR. 49, SERIA NPM07P,
DHËNË ME VENDIMIN E BORDIT NR.
61, DATË 2.11.2007, “PËR NDËRTIM,
INSTALIM, SHFRYTËZIMIN DHE
PRODHIMIN E ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA CENTRALE ME ERË
(PROJEKTI KAPPET)”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.2.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi transferimin e plotë të licencës së shoqërisë ‘Hera’ sh.p.k. nr. 49, seria NPM07P, dhënë me vendimin e Bordit nr. 61, datë 2.11.2007, “Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale me erë (projekti KAPPET)”, i ndryshuar,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 240, datë 2.12.2021, vendosi:

“1. Të fillojë procedurën për transferimin e plotë të licencës së shoqërisë “Hera” sh.p.k. me nr. 49, seria NPM07P, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 61, datë 2.11.2007, të ndryshuar, “Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale me erë (projekti KAPPET)”, me kapacitet të instaluar 150 mw, për një afat 30-vjeçar.

2. Vendimi përfundimtar për transferimin e licencës së shoqërisë “Hera” sh.p.k. do të merret pasi Bordi i ERE-s të jetë shprehur në lidhje me shtyrjen ose jo të afateve të plotësimit të kushteve të vendimit nr. 61, datë 2.11.2007, të ndryshuar.”.

- Në lidhje me pikën 2 të dispozitivit të vendimit nr. 240/2021, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 25, datë 13.12.2021, vendosi ndër të tjera:

“1. Të zgjasë me 9 (nëntë) muaj afatin e plotësimit të kushteve të vendosura në pikën 3.1, 3.2 dhe pikën 4, germat “a” dhe “b” (leja e mjedisit, dokumentacioni pronësor, miratimi nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale dhe dokumentacioni përkatës).”.

- Në vijim të vendimit nr. 240/2021, për fillimin e procedurës së transferimit të licencës së shoqërisë “Hera” sh.p.k., me nr. 49, seria NPM07P, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 61, datë 2.11.2007, të ndryshuar, u bë njoftimi në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure, me shkresën nr. 6/27 prot., datë 2.12.2021, dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve nga palët e treta (data 17.12.2021), nuk rezultoi asnjë koment.

- Sa i përket dokumentacionit të këtij aplikimi, gjatë shqyrtimit në Bord të kësaj praktike, lindi nevoja e dhënies së sqarimeve dhe depozitimit të dokumentacionit përkatës, në lidhje me sa më poshtë:

- Shoqëria “SOT-AL” sh.p.k. duhet të dokumentojë në ERE ekstraktin historik të saj të depozituar në QKB, me objektin e veprimtarisë të shtuar sipas titullit të licencës së shoqërisë “Hera” sh.p.k.: “Ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale me erë (projekti KAPPET)”;

- Shoqëria “SOT-AL” sh.p.k. duhet të dokumentojë në ERE numrin e punonjësve të dedikuar për veprimtarinë e licencuar që pretendohet t’i transferohet nga shoqëria “Hera” sh.p.k., si dhe profilin e tyre, në vijim të zotimit që kjo e fundit ka bërë në aktmarrëveshjen paraprake, të datës 30 nëntor 2021, me palë kërkuese shoqërinë “Hera” sh.p.k. dhe palë marrëse shoqërinë “SOT-AL” sh.p.k., në të cilën shkruhet se do të mbështesë me burime njerëzore plotësimin e kushteve të vendosura në licencë dhe afatet nga ERE për zbatimin e projektit;

- Shoqëria “SOT-AL” sh.p.k. duhet të dokumentojë në ERE kapacitetin e saj financiar, në përputhje me vlerën e investimit të këtij projekti, pasi të ardhurat e dokumentuara në ERE vlerësohen si të pamjaftueshme për të mundësuar zhvillimin e projektit KAPPET.

- Shoqëria “SOT-AL” sh.p.k. duhet të bëjë me dije nëse ka aplikuar në lidhje me rinovimin e



kontratave të qirasë të zonës ku do të zhvillohet projekti KAPPET dhe nëse po, t'i depozitojë ato në ERE, në vijim të parashikimeve të nenit 4, pika 3, të aktmarrëveshjes paraprake, të datës 30 nëntor 2021, me palë kërkuese shoqërinë “Hera” sh.p.k. dhe palë marrëse shoqërinë “SOT–AL” sh.p.k., ku ndër të tjera citohet se: “çdo palë është e detyruar të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të lejuar e kaluar të gjithë dokumentacionin që pala kaluese i transferon palës marrëse dhe lejuar palën marrëse të përmbushë detyrimet e parashikuara në lidhje me përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga licenca e ERE-s....”.

- Në mbështetje të nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me qëllim sqarimin/dokumentimin e konstatimeve të mësipërme, vlerësohet e arsyeshme shtyrja me 30 ditë pune e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Hera” sh.p.k. për transferimin e licencës së marrë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 61/2007, të ndryshuar, të shoqëria “SOT–AL” sh.p.k.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shtyjë me 30 (tridhjetë) ditë pune vendimmarrjen përfundimtare të Bordit të ERE-s, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Hera” sh.p.k. për transferimin e plotë të licencës së shoqërisë “Hera” sh.p.k. nr. 49, seria NPM07P, dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 61, datë 2.11.2007, “Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale me erë (projekti KAPPET)”, i ndryshuar, për plotësimin e dokumentacionit të munguar përpara marrjes së vendimit për transferimin e licencës të shoqëria “SOT–AL” sh.p.k.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 1029(5825), datë 16.12.2021, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Artan Kajo, i datëlindjes 28.8.1968, dhe vendosjen e tij nën kujdestarinë e shtetases Mimoza Brahimi (Kajo).

KËRKESË

Shtetasja Mynevere Hatija kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat shpalljen të zhdukur të shtetasit Lorenc Hatija, i datëlindjes 20.7.1974, dhe caktimin e një kujdestari për administrimin e pasurisë së tij.

KËRKUES
Mynevere Hatija

KËRKESË

Shtetasja Aleksandra Klemo kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat shpalljen të vdekur të shtetases Evanthe Klemo, e datëlindjes 26.10.1936, duke caktuar si datë vdekjeje datën 28.11.1944.

KËRKUES
Aleksandra Klemo

KËRKESË

Shtetasja Sofika Qako kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat shpalljen të vdekur të shtetasit Klodian Londo, i lindur në Berat më datë 8.7.1973, dhe banues në lagjen “Donika Kastrioti”.

KËRKUES
Sofika Qako

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë